REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. Prot **Bilisht më, __ /___/ 2025**

PROJEKT – VENDIM

Nr. 54 **datë** 23.09 **2025**

"PËR MIRATIMIN E LISTËS QË DO TË TRAJTOHEN ME SUBVENCIONIM QIRAJE PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të nenit 113 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenit 2 pika 42 nenit 33, nenit 34 dhe nenit 38 pika 3 të ligjit nr 22/2018 "Për strehimin social" I ndryshuar me ligjin 48/2023, VKM nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore" të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 për "Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Udhëzimi Nr. 23 datë 30.12.2008 "Për përmbajtjen e bonusit të strehimit" të VKB nr. 69 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025" të Bashkise Devoll.

PROPOZOJ:

1.Të miratojë listën e fituesve të subvencionimit të qirasë për 1 (një) familje të pastrehë si më poshtë:

Xhuljana Artan Ahmetlli

2.Vlera mujore e subvencionimit të qirasë është 5000 lekë për një familje. Kostoja totale është

60 000 lekë në vit nga këto 48 000 lekë në vit nga buxheti i shtetit dhe 12 000 nga buxheti i Bashkisë.

b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraje është sipas pikës 5, të nenit 30 të këtij ligji.

Neni 15

Rregulla të përzgjedhjes përmes sistemit të pikëzimit

1.Përzgjedhje e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike para fillimit të proçesit.

2.Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.

3.Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 33

1.Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira që ndihmon individët /familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose qirasë reale.

2.Masa e subvencionimt është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes.Subvencionimi mund të mbulojë deri 100 % të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Neni 34

Rregullat e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë

1. Subvencionimi i qirasë si rregull kryhet nga të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Subvencionimi i qirasë mund të bëhet edhe nga pushteti qendror, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 35, të këtij ligji.

2. Aplikimi i individit/familjes për të përfituar nga subvencionimi i qirasë do të bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve për subvencionimin e qirasë miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndërtohet banesa. Kur subvencionimi i qirasë financohet pjesërisht ose plotësisht nga qeverisja qendrore, lista e përfituesve, e miratuar nga bashkia, i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehimin, e shoqëruar me kërkesën për financim.

3. Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme:

a) individët me statusin e jetimit;

b) personat me aftësi të kufizuara;

c) të moshuarit;

ç) invalidët e punës;

d) familjet e policëve të rënë në detyrë;
dh) emigrantët e rikthyer;
e) punëtori emigrant;
ë) azilkërkuesit;
f) familjet e komunitetit rom;
g) familjet e komunitetit egjiptian;
gj) Viktimat e dhunës në familje;
h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë;
j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji;
k) të miturit, 14-18 vjeç, dhe të rinjtë, 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri;
l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara;
ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 01.03.2012.

Në datën 23.09.2025, Komisioni i Strehimit u mblodh për të shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga Znj. Xhuljana Artan Ahmetlli , nënë e vetme me dy fëmijë të mitur në ngarkim. Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit, Komisioni vendosi të shpallë fituese familjen e zonjës Xhuljana Ahmetlli dhe të miratojë ndihmën financiare për pagesën e qirasë.

Përfitimi:

Vlera e mbështetjes për këtë familje është 5,000 lekë në muaj për pagesën e qirasë. Nga kjo shumë, 80% e vlerës do të subvencionohet nga shteti, ndërsa 20% mbulohet nga buxheti i Bashkisë.

Ky vendim është marrë në përputhje me rregullat për mbështetje të familjeve me nevoja sociale .Bashkangjitur relacionit është lista përkatëse sipas familjevë që trajtohen me subvencionim qiraje dhe vlerën përfituese për secilën familjë sipas ligjit 22/2018 "Për strehimin Social

Konceptoi: Specialiste për Administrimin e Nevojave për Strehim
L. Laçi

Pranoi: Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
M. Bejleri

Konfirmoi: Drejtor i Drejtorisë të shërbimit.Social
Z. Sinani

Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
A.Rushitaj

Sipërfaqet për çdo lloj banese				
Nr.	Tipi i njësisë së banimit	Sipërfaqe Neto (m2)		
		Minimale	Maksimale	Vlera e qirasë
1	Studio	30	45	4000
2	1+1	40	55	5000
3	2+1	50	81	7000
4	3+1	60	100	9000

Pas verifikimit të dokumentacionit, Certifikatës familjare dhe të ardhurave periodike, familja e
Zni. Xhuliana Ahmetlli, përfiton me 42 pikë

Shtojca a) Sistemi i pikëzimit për programin "Subvencion Qiraje"

NR	KRITERET	PIKET
A	**KUSHTET E STREHIMIT**	**25 PIKE**
1	I pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore	4
2	I pastrehë nga proçeset gjyqësore	2
3	Banesë që prishet/përjashtohet nga legalizimi	2
4	Banesë në rrezik shembje	2
5	Nuk disponon banesë në pronësi	15
B	**KUSHTET FAMILJARE**	**25 PIKE**
6	Çift me moshë jo më të madhe se 60 vjeç.	7
7	Familje me më shumë se 4 fëmijë	4
8	I/E moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe nuk janë përzgjedhur për tu strehuar në një institucion publik të përkujdesjes	4
9	Famije njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijët	10
10	Asnjë nga kushtet	0
C	**KUSHTET SOCIALE**	**25 PIKE**
11	Anëtar i famijes që trajtohet me ndihmë ekonomike	2
12	Anëtar i komunitetit egjiptian	2
13	Anëtar i komunitetit rom	2
14	Azilkërkues	1
15	Emigrantët e rikthyer / punëtorët emigrantë	1
16	Familjet e punonjësit te Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	1
17	I mitur në konflikt me ligjin	1
18	Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës së ish-pronarëve	1
19	Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuar	4
20	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	1
21	Komuniteti LGBTI	1
22	Punonjës i RENEA-s	1
23	Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH)	1
24	Punonjës i shpëtimit dhe i mbrojtjes nga zjarri	1
25	Vajza-Nëna	1
26	Viktimë e dhunës në familje	3
27	Viktimë e trafikimit	1
28	Asnjë nga kushtet	0
Ç	**KUSHTET EKONOMIKE**	**25 PIKE**
29	Familje me të ardhura mesatare	1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

Nr.3069 Prot

Bilisht më 23.05.2025

RELACION

I LISTES QE DO TE TRAJTOHEN ME SUBVENCIONIM QIRAJE

PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2 i cili shprehimisht thotë:
Organet e njësive të qeverisjes vendore ushtrojnë kopetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhërave
- neni 9 pika 1.1/a dhe 1.1/5 i cili shprehimisht thotë:
Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes sipas së cilës:
a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave
- neni 30 pika 7 i cili shprehimisht thotë:
Të drejtën e bashkëpunimit sipas se cilës:
a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund te ushtrojnë së bashku çdo funkion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta të njëra – tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë dhe në zbatim të Ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimi Social" i ndryshuar, VKM nr.1093 datë 28.12.2015, "Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit" i ndryshuar, i cili përcakton qartë proçedurat dhe kriteret për dhënien e bonusit të strehimit për familjet e pastreha. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton gjithashtu dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë si dhe të njësive të instituconeve buxhetore në vartësi të bashkisë.
Entet menaxhuese në qytet, që kanë treg banesash me qira në bazë të vendimit të këshillit bashkiak i japin familjes që përfiton nga banesat sociale me qira, të cilat plotësojnë kushtet të përcaktuara në nenin nr. 36 "Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social" kur:
a) Nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.
b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave.
Në zbatim të pikës 2 të nenit 36 bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se:
a) familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira, e cila ndodhet pranë vëndit të punës, shkollës së fëmijëve, qëndrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

VENDIM

Nr.02 datë 23.09.2025
MBI
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI QIRAJE

Bazuar ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr.453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*" ndryshuar me vendimin nr. *268, datë 29.4.2022*, VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB Nr.17, datë 27.02.2025 "*Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit*",nivelit minimal dhe maksimalte te te ardhurave dhe dokumentacionit kredi te lehtesuar nga shteti qe duhet te plotesojne individët/familjet për tu trajtuar me programin e subvencionimit. VKB nr.2 datë 29.01.2025 për "*Miratimin e rregullores dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Devoll*" , Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.37 datë 25.01.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Devoll*"
Komisioni i Strehimit:

VENDOSi:

1. Të miratojë listën e përfituesve për programin Subvencioni Qiraje, sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur këtij Vendimi;

2. Ngarkohet Zyra e Strehimit:
   a) të përgatisë Projekt-Vendimin për t'u paraqitur në Këshillin Bashkiak, bazuar këtij Vendimi;
   b) të njoftojë familjen përfituese;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kujdesit Social dhe PAK, Sektori i Menaxhimit Financiar, Sektori Juridik dhe i Prokurimeve .

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 e ligjit 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

KRYETAR I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA DEVOLL

Konceptoi: Sp.e Admi të Nevojave për Strehim
L.Laçi

Pranoi: Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
M. Bejleri

Konfirmoi: Dr.Sherbimit Social
Z.Sinani

Konfirmoi bazën ligjore:
Përgj. Sek Juridik
E. Avdo

Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
A.Rushitaj

1. lista e përfituesve të programit të Strehimit Social,

Nr.	Emri/Atësia /Mbiemri	Pikë	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e Strehimit (shkronja "a", e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja "b", e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja "c", e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes/lekë	Punësimi	Vlera e subvencionit qirasë
1	Xhuljana Artan Ahmetlli	42	3	1+1	Nuk ka banesë në pronësi	-	Nënë e vetme që ka në ngarkim femijë		E papunë	5000

KOMISIONI I STREHIMIT

1. Ilerilda Bejleri
2. Luxela Gurshi
3. Orkidea Aude
4. TATJANA SPAHO
5. Linda Doçi
6. Ylson Stena
7. Juan Shano
8. Zerina Sinani

KRYETARI KOMISIONI

Zerina Sinani